

Klinika Stomatologjike Universitare njofton shpalljen e vëndit vakant në pozicionin Përgjegjës/e të Sektorit të Financës. Personat e interesuar duhet të plotësojnë këto kritere:

- Të zotërojnë një diplomë të nivelit “Master Shkencor” në shkencat Ekonomike, edhe Diploma e nivelit “Bachelor”, duhet të jetë në të njëjtën fushë. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni).
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”
- Të ketë mbi 5 vite përvojë pune në profesion ne institucionet publike.
- Te ketë aftësi në zbatimin buxhetit të miratuar për institucionin.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- Të njohë të paktën një nga pesë gjuhët e BE-së (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht dhe italisht)
- Njohje shumë e mirë e paketës Microsoft Office, Financa 5, Alpha.
- Të ketë aftësi komunikuese dhe gjyquese mbi hartimin e dokumentave në fushën ekonomike-financiare.

Përshkrimi i punës

Detyrat kryesore të Përgjegjës/e të Sektorit të Financës

- a. Përgjegjësi i Sektorit të Financës varet nga Drejtori i institucionit.
- b. Emerimi dhe shkarkimi I tij behet nga Drejtori I Institucionit .
- c. Përgjegjësi i Sektorit të Financës për ushtrimin e detyrës së tij përgjigjet para Drejtorit dhe Drejtorise se Planifikimit Financiar ne Ministrine e Shendetetesise.
- d. Organizon, drejton dhe kontrollon të gjithë veprimtarinë ekonomike-financiare të institucionit duke mbajtur përgjegjësi për funksionin e saj sipas legjislacionit në fuqi.
- e. Së bashku me Drejtorin e institucionit dhe Përgjegjësin e Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse dhe Burimeve Njerëzore organizon dhe drejton punën për hartimin e projekt-buxhetit duke bashkërenduar hallkat që kanë në varësi për evidentimin e nevojave materiale për mbarëvajtjen e klinikës.
- f. Përgjigjet për realizimin e plan-buxhetit të miratuar sipas zërave përkatës.
- g. Përgjegjësi i sektorit te finances rekomandohet nga drejtori si kryetar I komisionit te prokurimeve harton urdher prokurimet si dhe prokuron fondet publike .
- h. Përgjegjësi I sektorit te finances ne baze te urdherave te prokurimeve te firmosur nga drejtori , drejton dhe zhvillon tenderat sipas ligjeve ne fuqi .
- i. Organizon dhe drejton punën dhe përgjigjet për sigurimin e bazës materiale të nevojshme për pacientin dhe për sigurimin e shërbimit,për administrimin dhe shfrytëzimin racional të këtyre materialeve, plotëson nevojat e administratës së institucionit, të shërbimeve e reparteve me inventarin e pajisjet e nevojshme.
- j. Analizon realizimin e shpenzimeve operative sipase fondeve të planifikuara dhe ecurinë e shërbimeve nëpërmjet raportimeve që bëjnë degët përkatëse.
- k. Organizon marrjen e masave për zbatimin e rregullave për qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare që lidhen me blerjen e materialeve, medikamenteve e kryerjen e shërbimeve.
- l. Analizon zbatimin e normativave në harxhimin e materialeve mjekësore të shërbimit, gjendjen e mallrave në magazinë dhe me qarkullim të ngadalshëm dhe merr masa për normalizimin e tyre, nëse ka të tilla.

- m. Organizon dhe drejton sipas ligjeve administrimin e ndihmave humanitare, dhuratave apo donacioneve nga organizata të ndryshme, duke i trajtuar ato si të gjithë mallrat e tjera të cilat blihen sipas ligjit të prokurimeve.
- n. Organizon vendosjen e dokumentacionit dhe të qarkullimit të vlerave materiale sipas akteve ligjore e udhëzimeve përkatëse në të gjitha hallkat e shërbimit parësor të klinikës.
- o. Në bashkëpunim me Drejtorin ndjek zbatimin e detyrave në fushën e investimve e të ndërtimeve në shkallë institucioni.
- p. Rakordon me Thesarin mbi buxhetin e vënë në dispozicion për investimet.
- q. Organizon dhe merr masa për ruajtjen e dokumentacionit të institucionit dhe të administrimit të rregullt në arkiv sipas rregullave të caktuara.
- r. Pezullon çdo veprim që kryhet në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe rregullat e caktuara në fushën ekonomike-financiare, të furnizimit me materiale e medikamente dhe shpërndarjen e tyre në destinacion për shërbimin ndaj pacientit, ndërhyr në organet përkatëse për marrjen e masave.

Adresa: Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë Tel: 04 2375265, email: info@ksu.al

- s. Ndjek dhe analizon herë pas here mirëmbajtjen e riparimin e ambienteve të punës (si ndërtesa, pajisje mjekësore, pajisje zyre, mobilime, elektronika, etj.), të cilat kanë të bëjnë me objektet pasurore që janë në funksion të institucionit.
- t. Merr masa për sigurimin e institucionit dhe mbrojtjen nga zjarri sipas ligjeve në fuqi.
- u. Organizon dhe udhëheq kontrollin ekonomik-financiar që ushtrohet sipas një programi, kontroll kompleks në të gjithë veprimtarinë e shërbimeve të klinikës, në periudha vjetore, 3/mujore e mujore.
- v. I propozon Drejtorit të Klinikës të marrë masa disiplinore, të bëjë çdëmtimin e vlerave materiale e monetare, harxhimit mbi normat e miratuara, ose kallëzimin e veprave penale për ata punonjës të institucionit që thyejnë disiplinën e punës, dëmtojnë pronën e institucionit etj.
- w. Merr masa për administrimin me efikasitet të fondeve të akorduara, respektimin e procedurave e të afateve kohore lidhur me realizimin e fondeve sipas planifikimit.
- x. Detyra të tjera që caktohen nga Drejtori i Klinikës Stomatologjike Universitare.

Kandidatët duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë pranë protokollit të Klinikës Stomatologjike Universitare dokumentat si më poshtë :

Një listë përmbledhëse e të gjithë dokumenteve që dorëzohen, e cila duhet të jetë e nënshkruar në mënyrë të rregullt nga kandidati.

- 1.Një kërkesë për aplikim e cila duhet të përmbajë në formë të përmbledhur kërkesën për punësim në pozicionin e shpallur.:
- 2.Jetëshkrim sipas standarteve
- 3.Diplome e noterizuar , së bashku me listën e notave të diplomës e krediteve të marra.
- 4.Librezë Pune *(të gjitha faqet që vertetojnë eksperiencën në punë të vërtetuara nga e _albania)*.
- 5.Fotokopje e letërnjoftimit (ID).

- 6.Dokumentin që vërteton njohjen e gjuhës së huaj.
- 7.Vërtetimin e gjendjes shëndetësore dhe për aftësinë për punë *(nga KML)*.
- 8.Vërtetimin e gjendjes gjyqësore ose formulari i plotësuar që autorizon institucionin për verifikim.
- 9.Rekomandime, në rast se ka, mundësisht nga punëdhënësi i fundit.
- 10.Vërtetimin nga institucioni që ka punuar dhe që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- 11.Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Mosparaqitja e plotë e dokumentave të sipërcituar brenda afatit të përcaktuar në shpallje, sjell skualifikimin e kandidatit.

Përzgjedhja e kandidatit do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtpërdrejta.

Mënyra e vlerësimit:

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurrimit me dosje dhe me intervista të drejtpërdrejta.

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Në lidhje me intervistën e punës kandidatët do të vlerësohen për njohuritë mbi legjislacionin e sipërcituar, aftësitë, **kompetencat, eksperiencën e tyre të mëparshme, motivimin, aspiratat si dhe pritshmërinë e tyre për karrierën.**

Për çdo paqartësi mund të dërgohet e-mail në adresën KSU@shendetesia.gov.al